



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1048/4Prot.

Tiranë, më 23. 07. 2025

V E N D I M

Nr. 172, datë 23. 07. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.152 Regj., datë 04.07.2025 e znj. E. B., kundër Drejtorisë Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendja ekonomike”, “përgjegjësia prindërore”, “gjendja shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj. E. B., në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se: *Unë, E. B., me profesion Punonjëse Sociale, paraqes këtë ankesë ndaj institucioneve arsimore dhe strukturave të vartësisë për shkak të një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues që ka ndodhur me ndërprerjen e padrejtë të marrëdhënies financiare me DRAP Tiranë. Kam konkuruar për dy vite rresht (2023 dhe 2024) në DRAP Durrës, duke rezultuar fituese dhe kam punuar dy vite shkollore në shkollat publike në Tiranë, përkatësisht në shkollën e mesme të Bashkuar “Mustafa Kemal Atatürk” Zall-Herr, Tiranë dhe 2024-2025 në shkollën 9-vjeçare “Marie Logoreci” Tiranë, ku kam kontribuar në mënyrë të përkushtuar dhe korrekte. Vitin shkollor 2023-2024 me kontratë me afat të përcaktuar, ndërsa vitin shkollor 2024-2025, kontrata e lidhur në DRAP Durrës më 08.10.2024 është me afat të pa përcaktuar, duke qenë se kishte një kërkesë nga UPS Shqipëri për MAS për punësim të Punonjësve Socialë në pritje të provimit të shtetit, i pari i këtij lloji në Shqipëri. Është edhe arsyeja që procedurat zgjatën dhe nuk ka të bëjë me neglizhencë personale për mos pajisjen me licencë, por me Çertifikatë Praktikanti deri në ditën e provimit të shtetit. E konsideroj diskriminues faktin e ndërprerjes së kontratës, duke*

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

mos dhënë një mundësi deri në licensim, ndërkohë që kam krijuar urat lidhëse dhe kam fituar një eksperiencë, dhe ndërrimi i personelit vazhdimisht nuk është në të mirën askujt, sidomos të nxënësve. Nxjerrja e vendeve vakante të stafit psiko-social na përjashton automatikisht edhe nga gara, të gjithë personave që mund të jenë në këto kushte, duke punësuar persona të rinj pa eksperiencë.

Më datë 13.06.2025, për shkak të problemeve shëndetësore, kam dorëzuar një raport mjekësor për 14 ditë pushim të ligjshëm, siç parashikon legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe respektimin e kohës së rikuperimit. Ky raport nuk u mor parasysh nga institucionet përkatëse, edhe pse nuk kam marrë raport mjekësor më parë. Vetëm tre ditë më pas, më 16.06.2025, është marrë vendimi për shkëputjen e marrëdhënies financiare me institucionin, duke injoruar qartë statusin tim mjekësor dhe duke ndërhyrë në mënyrë të papranueshme gjatë një periudhe të mbrojtur me dokumentacion shëndetësor.

Për praninë e këtij vendimi u njoftova vetëm më datë 26.06.2025 nga drejtori i shkollës, që do të thotë se jo vetëm që nuk jam informuar në kohë reale, por edhe jam lënë në pasiguri dhe cenim të dinjitetit profesional, duke qenë se ligjërisht unë duhet të dorëzoj, plotësoj të gjitha detyrat e kërkuara edhe pse marrëdhënia financiare është ndërprerë. Për shkak të këtij vendimi, dëmi psikologjik, emocional dhe sigurisht ekonomik për mua është i konsiderueshëm, duke qenë në statusin e kryefamiljares.

Në këtë mënyrë, unë dhe kolegët e mi praktikantë jemi trajtuar si numra, pa interes dhe pa asnjë ndjeshmëri njerëzore apo institucionale për përpjekjet, angazhimin dhe gjendjen tonë. Jam përjashtuar jo vetëm nga një marrëdhënie pune që e kam ndërtuar me përkushtim, por edhe nga vetë gara për një vend pune për vitin e ardhshëm, pa asnjë alternativë reale për mbështetje apo riintegrim.

Ky trajtim përbën një diskriminim të shumëfishtë mbi bazë të gjendjes shëndetësore (mosrespektimi i lejes mjekësore), përgjegjësisë prindërore, statusit familjar dhe gjinisë, duke dëmtuar seriozisht jo vetëm situatën time ekonomike dhe emocionale, por edhe të drejtën time për të ndërtuar një jetë profesionale me dinjitet dhe barazi.

Jam nënë e katër vajzave të cilat i kam rritur me përkushtim dhe dinjitet, duke u përpjekur gjithnjë të mos bëhem barrë për askënd. Vajza ime më e vogël përfiton një pension ushqimor prej rreth 10 mijë lekësh në muaj si mbështetje pas ndarjes nga jeta të babait të saj në vitin 2019, por ky përfitim është i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat bazë të saj.

Për shkak të prioritetit të arsimit, kemi marrë vendimin që vajzat të mos punojnë deri në përfundim të studimeve të tyre, për arsyen se dy vajzat e mëdha, të cilat jetojnë aktualisht më vete, janë detyruar të punojnë që në moshën 18-vjeçare, shpesh duke ndërprerë studimet për t'iu përgjigjur nevojave ekonomike të familjes. Megjithatë, sot ato nuk janë në pozicion të më ndihmojnë financiarisht. Deri tani kam qenë unë mbështetësja e vetme kryesore. Kam bërë gjithçka me ndershmëri për të fituar statusin profesional të një punonjëseje sociale, për të ndihmuar individë, familje dhe grupe në nevojë. Kjo përpjekje është shoqëruar me shumë

sakrifica personale dhe familjare. Ndaj përjashtimi im nga mundësia për të ushtruar këtë profesion nuk është vetëm padrejtësi administrative, por edhe një dëm emocional e moral që më cënon si grua, nënë dhe qytetare.

Në këto kushte, ju kërkoj me përlësi dhe besim që ta trajtoni me seriozitet dhe ndjeshmëri ankesën time. Nuk mund të rikthehem në jetë pa dinjitet, ndërkohë që vetë një punonjëse sociale përjashtohet nga puna pa asnjë bazë të drejtë apo humane.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri:

1. Të shqyrtohet ankesa në mënyrë të paanshme, të plotë dhe me ndjeshmëri, duke marrë në konsideratë kontekstin social dhe familjar në të cilin ndodhet.
2. Të urdhërohen institucionet përkatëse të japin përgjegjësi të qarta për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të njëanshme, gjatë kohës së vlefshmërisë së lejes mjekësore, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes ligjore të punonjësve në gjendje të mbrojtur.
3. Të rekomandohet riintegrimi i saj në një marrëdhënie pune të qëndrueshme, në pozicionin për të cilin jam trajnuar dhe kam kontribuar, ose, në mungesë të kësaj, të urdhërohet kompensimi i dëmit ekonomik dhe moral nga institucionet përgjegjëse për shkeljet e padrejtë të marrëdhënies së punës.
4. Të sugjerohet dhe promovohet trajtimi me dinjitet dhe mbrojtje institucionale për stafin psiko-social në shkollë, veçanërisht në rastet kur ata përballen me vështirësi ekonomike, sociale apo shëndetësore, duke pasur parasysh rolin thelbësor që ky staf ka në ruajtjen dhe zhvillimin e shëndetit mendor të nxënësve dhe të komunitetit shkollor në tërësi.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjen shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektet nga të cilët pretendon se diskriminohet, apo me të drejtën ligjore të saj.

- Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr.1048/1 prot., datë 07.07.2025, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të saktësojë dhe dokumentojë shkaqet e pretenduara, lidhjen e tyre me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë a të pafavorshëm, si dhe të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, me shkresën nr. 1048/2 prot., datë 11.07.2025, të Komisionerit, është administruar përgjigjja e ankueses, e cila ka ripërsëritur pretendimet e parashtuara në ankesë.

I. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me gjininë, racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose

martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

Pas analizimit sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

- Në bazë të Vendimit nr. 178, datë 08.10.2024 të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, znj. E. B., është emëruar si punonjës i shërbimit psiko-social, P. Social në IPA “Marie Logoreci”, Tiranë, ZVAP Tiranë. Në pikën 2 të këtij urdhri është parashikuar se kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës do të bëhet sipas kontratës individuale të punës, bashkëngjitur këtij urdhri.
- Në bazë të Kontratës së Punës nr. 2377/2 prot., datë 08.10.2024, në cilësinë e punëdhënësit Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, në cilësinë e punëmarrësit znj. E.B., ankuesja është punësuar në pozicionin e punës punonjës i shërbimit psiko-social, P. Social në IPA “Marie Logoreci”, Tiranë, ZVAP Tiranë. Kontrata individuale e punës, neni 4, pika 3, ka specifikuar qartë që kjo kontratë ndërpritet në fund të procesit mësimor në rast mosmarrjeje provimi licence në Urdhrin e Punonjësit Social.
- Në bazë të Vendimit nr. 25, datë 16.06.2025 të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, znj. E. B., i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në zbatim të nenit 4, pika 3 të kontratës së punës, ku është specifikuar që kontrata ndërpritet në fund të procesit mësimor në rast mosmarrjeje provimi licence në Urdhrin e Punonjësit Social.

- Kopje e çertifikatës së praktikës profesionale, e datës 24.05.2024, që është e vlefshme vetëm për periudhën e kryerjes së praktikës profesionale.
- Ankuesja ka vënë në dispozicion kopje të diplomave të saj, të kualifikimeve dhe të vlerësimit të performancës së saj gjatë punës.
- Kopje të çertifikatës së gjendjes familjare, të datës 07.01.2020.
- Sipas Raportit datë 13.06.2024 të Qendrës Shëndetësore Shkozë, Tiranë, znj. E. B., i janë dhënë 14 ditë pushimi deri më datën 27.06.2024.
- Ankuesja ka dërguar e-maile edhe te “Bashkëqeverisja”, dhe nga ana e Ministrisë së Arsimit i është kthyer përgjigje në lidhje me procedurën e marrjes së licencës së punonjësit të shërbimit psiko-social. Ndërkohë është saktësuar që kontrata e znj. B., është me afat të caktuar.
- Sipas Deklaratës së Qendrës së Shërbimit Arsimor, rezulton që më datën 08.07.2025 ka dhënë provimin e shtetit në profesionin e punonjësit social, vërtetuar edhe me Vërtetimin (Provimi VAP) të datës 19.06.2025 të Urdhrit të Punonjësit Social, ku ankuesja rezulton kaluese.

Lidhur me pretendimin e ankueses znj. E. B., për diskriminim nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, periudhë që ishte me raport mjekësor, Komisioneri vëren se:

Bazuar në Vendimin nr. 178, datë 08.10.2024 të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, znj. E. B., është emëruar në pozicionin “*Punonjës i shërbimit psiko-social, P. Social*” pranë IPA “Marie Logoreci”, Tiranë, ZVAP Tiranë. Në pikën 2 të këtij urdhri është parashikuar se kohëzgjatja e marrëdhënies së punës do të përcaktohet sipas kontratës individuale të punës, bashkëngjitur këtij urdhri.

Në bazë të Kontratës Individuale të Punës nr. 2377/2 prot., datë 08.10.2024, të lidhur mes Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe znj. E. B., rezulton se pozicioni i punës së ankueses ka qenë me kontratë që, megjithëse në titull figuron si “*kontratë me afat të pacaktuar*”, në përmbajtje përmban një klauzolë për përfundim automatik, konkretisht në nenin 4, pika 3, ku është përcaktuar se: “*kontrata ndërpritet në fund të procesit mësimor në rast të mosmarrjes së provimit të licencës në Urdhrin e Punonjësit Social.*”

Në vijim, në bazë të Vendimit nr. 25, datë 16.06.2025 të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, znj. B., i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, pikërisht në zbatim të kësaj dispozite kontraktuale, pasi në atë moment ajo ende nuk ishte licencuar nga Urdhri i Punonjësit Social.

Ndërkohë, dokumentacioni i paraqitur tregon se znj. B., ka qenë me raport mjekësor nga Qendra Shëndetësore Shkozë (raporti datë 13.06.2024 deri më 27.06.2025, për 14 ditë pushim).

Bazuar në këto fakte, Komisioneri konstaton se ndërprerja e marrëdhënies së punës ndaj ankueses është bërë në përputhje me dispozitat e kontratës së punës, përkatësisht nenin 4, pika

3, ku është sanksionuar qartë se vijueshmëria e kontratës kushtëzohet me marrjen e licencës nga Urdhri i Punonjës Social për ushtrimin e këtij profesioni.

Sipas nenit 149 të Kodit të Punës, kontratat me afat të caktuar përfundojnë në fund të periudhës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. Në këtë rast nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 147 i Kodit të Punës, i cili parashikon mbrojtje nga zgjidhja e njëanshme në kohë të papërshtatshme, pasi kjo dispozitë aplikohet vetëm për kontratat me afat të pacaktuar.

Kontratat që përmbajnë kushte të posaçme për përfundimin e marrëdhënies, si për shembull përfundimi i një afati apo mospërmblidhja e një kushti profesional (në këtë rast, licencimi), përfundojnë automatikisht nëse plotësohet kushti përkatës, pa qenë e nevojshme një zgjidhje e njëanshme apo njoftim i veçantë.

Kontrata individuale e punës e lidhur me znj. B., përmbante një klauzolë të qartë në nenin 4, pika 3, sipas së cilës kontrata përfundonte automatikisht në fund të procesit mësimor në rast të mosmarrjes së licencës nga Urdhri i Punonjës Social – një kërkesë ligjore dhe profesionale për ushtrimin e detyrës së punonjës social. Në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ky kusht nuk ishte përmbushur, çka përbën një arsye të bazuar objektivisht dhe të lidhur ngushtë me natyrën e pozicionit të punës. Ndaj, ndërprerja e kontratës nuk lidhet me ndonjë kriter të ndaluar nga ligji dhe nuk përbën formë diskriminimi, por është pasojë e drejtëpërdrejtë e zbatimit të një klauzole kontraktuale dhe të një kërkesë ligjore të domosdoshme për ushtrimin e profesionit. Në këto kushte, bazuar në rrethanat e paraqitura dhe në dokumentacionin përkatës, rezulton se ndërprerja e marrëdhënies së punës me znj. E.B., është kryer për një shkak të ligjshëm dhe objektivisht të justifikueshëm, në kuptim të nenit 3, pika 12 të Ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të ndryshuar.

Në këtë rast, znj. B., ka përmbushur kushtin për licencim vetëm pas përfundimit të vitit shkollor dhe pas datës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ndaj kjo nuk mund të sjellë efekte prapavepruese mbi vlefshmërinë ligjore të ndërprerjes.

Sipas legjisllacionit në fuqi, licenca profesionale përbën një kriter të domosdoshëm dhe të pazëvendësueshëm për emërimin dhe ushtrimin e funksionit të punonjës të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar. Konkretisht, Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020 i Ministrit të Arsimit, “Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social...”, përcakton qartë se personeli i këtij shërbimi duhet të plotësojë kriteret ligjore të kualifikimit profesional, përfshirë licencën përkatëse të lëshuar nga Urdhri i Psikologut ose i Punonjës Social, sipas rastit. Në mungesë të kësaj licence, marrëdhënia e punës mund të jetë vetëm e përkohshme ose provizore dhe, në përfundim të afatit apo periudhës së provës, nëse nuk është marrë licenca, institucionet arsimore nuk kanë detyrim ligjor për vijimin e marrëdhënies së punës.

Pas pajisjes me licencë profesionale nga Urdhri i Punonjës Social, individët që synojnë të ushtrojnë funksionin e punonjës psiko-social në institucionet arsimore duhet t’i nënshtrohen

procedurave të konkurrimit publik. Kjo kërkesë rrjedh nga zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.02.2019, i ndryshuar, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar...”, si dhe nga Urdhri nr. 144 i Kryeministrit, “Për strukturën dhe organikën e drejtorive rajonale”. Këto akte parashikojnë se emërimi i personelit mbështetet mbi konkurse të hapura dhe transparente, në përputhje me kërkesat për vendin vakant. Rrjedhimisht, edhe në rastin e znj. B., pavarësisht se ajo ka marrë licencën më datë 08.07.2025, kjo nuk përbën e drejtë automatike për rikthim në vendin e mëparshëm të punës, por e kualifikon atë për të konkurruar në procedura të hapura për pozicionin përkatës në përputhje me rregullat dhe strukturën e miratuar për institucionet arsimore publike.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, ankesa e znj. E. B., ndaj Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, përmban pretendime për diskriminim në vendin e punës, me shkaqe të tjera të pretenduara si “gjinia”, “gjendja ekonomike” “përgjegjësia prindërore”.

Ndërkohë, në lidhje me shkaqet e pretenduara në ankesë, subjekti ankues, në rastin në fjalë, ka paraqitur dokumentacionin për të vërtetuar në vetvete shkaqet e pretenduara, por, pavarësisht këtij fakti, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk ka dhënë asnjë shpjegim të arsyeshëm apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, apo se si ky trajtim lidhet me këto shkaqe.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet e sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këtë shkak, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte e prova mbi të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur një diferencë në trajtimin ndaj saj nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, që të jetë motivuar nga shkaqe të pretenduara si “gjinia”, “gjendja ekonomike” “përgjegjësia prindërore”.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Referuar sa më lart, ankuesja nuk solli prova e fakte mbi të cilat mund të prezumohet se diferenca në trajtim i ka ardhur për shkaqet e pretenduara, si dhe nuk ka sqaruar apo specifikuar në asnjë moment sesi lidhen këto shkaqe (*gjinia*”, “*gjendja ekonomike*”, “*përgjegjësia prindërore*”) me pasojat e pretenduara, konkretisht me përfundimin e marrëdhënies së punës. Ajo nuk ka paraqitur asnjë element faktik apo provues që të mbështesë ekzistencën e një lidhjeje shkak-pasojë midis statusit të saj dhe trajtimit të supozuar të padrejtë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Në mungesë të një pasqyrimi të qartë dhe të dokumentuar të mënyrës se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në vendimet e marra nga punëdhënësi ndaj saj, pretendimi për diskriminim mbetet i pambështetur në prova dhe rrethana konkrete.

Ndërkohë znj. E. B., në ankesën e saj ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe për shkak të “çdo shkakut tjetër”.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se është diskriminuar “për çdo shkak tjetër” pa identifikuar asnjë shkak konkret, i cili më pas të vlerësohej nga ana e Komisionerit nëse përbën ose jo një shkak që gëzon mbrojtje, nuk përbën një pretendim për diskriminim, sipas parashikimeve të LMD-së, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesja nuk arriti ta provonte e dokumentonte përmes fakteve dhe rrethanave konkrete se kishte një lidhje shkak-pasojë midis statusit të saj të pretenduar në ankesë dhe përfundimit të marrëdhënies së saj të punës me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk mund të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/dh, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues znj. E. B., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA